



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:275047
Datë: 15.07.2024
Numri i dokumentit: 05938709

K.DH.SH.II.nr.636/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Franciska Zhitija Ymeri, kryetare e kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Faton Bajrami, anëtarë të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “ Eurokos” JH” Shpk, me seli në Ferizaj, me numër unik identifikues 810665333, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Ardë Rifaj, avokat nga Dragashi, kundër të paditurit Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me seli në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit dhe të paditurës ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.1418/22 i datës 29.01.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 11.07.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si e pabazuara, ankesa e paditësit “Eurokos JH” Shpk me seli në Ferizaj e datës 15.02.2024 dhe ankesa e të paditurit Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me seli në Prishtinë, e datës 16.02.2024, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.1418/22 i datës 29.01.2024, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, në pikën I. të dispozitivit është aprovuar pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Eurokos JH” Shpk kundër të paditurit Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Nën pikën II. Anullohet vendimi KSHA.nr.43/22 i datës 10.04.2022 (nr.prot.4115-3/22 datë 11.10.2022 i nxjerr nga i padituri Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës-Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave. Nën pikën III. Hedhet si e palejuar kërkesëpadia e paditësit “Eurokos JH” Shpk me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se paditësi është pajisur me leje mjedisore për njësitë “HC Brodi2” nr. 810265037, “HC Brodi 3” nr. 810165053 dhe “Restelica 1&2” nr. 810265045 pas miratimit në heshtje të kërkesës për leje mjedisore nr.prot 4115/16 të datës 19.09.2016, kërkesës me nr.prot 5629/20 të datës 04.12.2020 dhe kërkesës nr.prot.3635/21 të datës 09.09.2021 për njësitë “HC Brodi 2” nr.810265037, “HC Brodi 3 nr.810165053” dhe “Restelica 1&2” nr.810265045. nën pikën IV. Shtyrja e ekzekutimit të vendimit KSHA.nr.43/22 i datës 10.04.2022 i protokoluar me numër prot.4115-3/22 datë 11.10.2022 sipas aktvendimit të kësaj gjykate KA.nr.1418/22 të datës 16.12.2022, mbetet në fuqi deri në plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi. Nën pikën V. Ky aktgjykim i zëvendëson aktet e anuluar dhe ka karakter detyrues. Nën pikën VI. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi i padituri, ka ushtruar ankesë me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës administrative, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet në tërësi ankesa e të paditurës Ministria e Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës si e themeltë. Të prishet aktgjykimin KA.nr.1418/22 i datës 29.01.2024 duke vendosur meritorisht, të refuzohet në tërësi si e pa themeltë kërkesëpadia e paditësit dhe të mbetet në fuqi vendimi me nr. KSHA-43/22 i datës 10.04.2022.

Kundër aktgjykimit të Dhomës së Shkallës së Parë ka ushtruar ankesë paditësi përmes përfaqësuesit të autorizuar, me të cilën e kundërshton ligjshmërinë e tij për shkak të: vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me

propozim që Dhoma e Shkallës së Dytë, Departamenti për Çështje Administrative ta aprovoj ankesën si të bazuar, edhe për pjesën e dispozitivit në pikën III. të aktgjykimit, me të cilën vërtetohet se paditësi është pajisur me leje mjedisore për njësitë “HC Brodi2” nr.810265037, “HC Brodi 3” nr.810165053 dhe “HC Restelica 1& 2” nr.810265045.

Përgjigje në ankesë nuk është paraqitur.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë shqyrtoi shkresat e lëndës aktgjykimin e ankimuar pretendimet në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre si në vështrim të nenit 49 të LKA, dhe neni 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, (LPK),i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA, gjeti se:

Ankesat janë të pabazuara.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e të paditurit, numër KSHA- 43/22 datë 10.04.2022, është refuzuar ankesa me nr.prot 4115-2/22 e datës 09.08.2022 e ushtruar nga “Eurokos JH” ShPK “HC Brodi2”, “HC Brodi 3” dhe “HC Restelica 1& 2”, i përfaqësuar nga Y.Sh. si person përgjegjës, vërtetohet aktvendimi i Inspektoratit të Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit me nr. prot 4115-2/22 datë 29.07.2022 dhe nr. refer. 22-INS-SK-23-PV-25 i datës 20.06.2022.

Kundër Vendimit të paditurit, paditësi inicicion konflikt administrativ, me padi i drejtohet gjykatës Dhoma e Shkallës së Parë, në këtë çështje juridike administrative, me datë 23.01.2024, mban seancë të shqyrtimit kryesor në prani të autorizuarve të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit e në mungesë të përfaqësueses së paditurës dhe pas administrimit të provave, merr aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e aprovon pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, anulon vendimin KSHA.nr.43/22 të datës 10.04.2022 dhe shtyhet ekzekutimi i vendimit KSHA.nr.43/22 i datës 31.04.2022 të protokoluar me numër prot. 4115-3/22 datë 11.10.2022, sipas aktvendimit të kësaj gjykate KA.nr.1418/22 i datës 16.12.2022, mbetet në fuqi deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit, me arsyetim se; Gjykata i vlerësoi si pjesërisht të bazuara pretendimet e paditësit sepse të njëjtat kanë mbështetje në gjendjen faktike dhe janë në përputhje me provat e administruara në këtë çështje dhe dispozitat ligjore materiale që rregullojnë këtë çështje. Gjykata nga provat e administruara

në këtë çështje, përkatësisht nga përmbajtja e arsyetimit të vendimit nr.rend. 7/2022 dhe nr. prot. 22-INS-SK-23-PV-25 të datës 29.07.2022, konstatoi se paditësi fillimisht ishte pajisur me Pëlqim Mjedor nga MMPHI dhe gjithashtu ishte pajisur edhe me Leje Ujore nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit dhe me Leje të Ndërtimit nga Komuna e Dragashit për ndërtimin e "HC Brodi 2", "HC Brodi 3" dhe "Restelica 1 &2", për çfarë pas ndërtimit të hidrocentraleve kishte marrë Certifikatat mbi përdorimin e Objekti "HC Brodi 2", "HC Brodi 3" dhe "Restelica 1 &2. Gjykata gjeti se paditësi më 19.09.2016 kishte paraqitur kërkesën nr.prot.4115/16 për leje mjedisore për ndërtimin e hidrocentralit "HC Brod 2", ndërsa më datën 04.12.2020, kishte paraqitur kërkesën nr. 5629/20 për leje mjedisore për ndërtimin e hidrocentralit "HC Brodi 3" si dhe me datën 09.09.2021 kishte paraqitur kërkesën nr.prot. 3635/21 për ndërtimin e Hidrocentralit" Restelica 1 & 2", mirëpo i padituri nuk kishte nxjerr vendim konform nenit 10 par. 1 të UA Nr. 07/2017 Për Leje Mjedisore, i cili siç u theksua përcakton afatin 90 ditorë për nxjerrjen e vendimit aprovues apo refuzues. Meqenëse i padituri nuk kishte vepruar brenda afateve të lartcekura për refuzimin apo aprovimin e lejes mjedisore, gjykata gjeti se paditësi sërish i ishte drejtuar të paditurit me kërkesën për lëshimin e vërtetimit mbi miratimin në heshtje të lejeve mirëpo, as pas kësaj kërkesë nuk kishte marr përgjigje, çfarë gjykata vlerëson se paditësi me të drejtë ka konsideruar i janë miratuar në heshtje kërkesat për pajisje me leje mjedisore. Lidhur me këtë, gjykata vlerëson se paditësi ka pasur pritshmëri legjitime dhe të arsyeshme se pasi që i padituri nuk ka nxjerrë vendim lidhur me kërkesat për pajisje me leje mjedisore brenda afateve ligjore, të njëjtit i janë aprovuar të njëjtat. Gjykata vlerëson se i padituri përmes nxjerrjes së vendimit të inspektimit me nr.rend. 7/2022 dhe nr. prot. 22-INS-SK-23-PV-25 të datës 29.07.2022, me të cilin kishte urdhëruar paditësin që të ndaloj përkohësisht procesin e punës në njësinë "HC Brod 2", "HC Brod 3" dhe "Restelica 1&2", ka vepruar në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit, ku me nenin 5 të LPPA-së përcaktohet se: *"1. Një veprim administrativ, që për arsye të mbrojtjes së interesit publik kufizon apo cenon të drejtat apo interesat juridike të një personi, duhet të jetë në pajtim me parimin e proporcionalitetit. 2. Një veprim administrativ është në pajtim me parimin e proporcionalitetit vetëm nëse i plotëson këto kushte: 2.1. është i domosdoshëm për të arritur qëllimin e përcaktuar në ligj; 2.2. është i përshtatshëm për të arritur qëllimin e përcaktuar në ligj, dhe 2.3. kufizimi apo cenimi i të drejtës apo interesit juridik nuk është në shpërpjesëtim me realizimin e qëllimit të ndjekur."* Kjo pasi që vendimi i të paditurit që të ndërpres punën e paditësit përderisa i njëjti paraprakisht ishte pajisur me të gjitha

lejet/pëlqimet e kërkuara për ndërtimin e hidrocentraleve, ndërsa pas përfundimit të ndërtimit i njëjti kishte aplikuar për pajisje me leje mjedisore, ndërsa i padituri nuk kishte vepruar brenda afateve ligjore të përcaktuara, paditësit kishte konsideruar se është pajisur me leje mjedisore përmes aprovimit në heshtje, andaj gjykata vlerëson se ndalimi i procesit të punës nga i padituri është në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit, respektivisht në kundërshtim me dy kushtet e përcaktuara në par 2, nën par. 2.1 dhe 2.2 të këtij neni, përderisa i njëjti organ administrativ pranë vetes ka pasur një kërkesë të paditësit dhe nuk ka vendosur për të njëjtën brenda afateve ligjore dhe as deri më tani gjatë shqyrtimit të kësaj çështje. Andaj gjykata vendosi si në dispozitivin I, II dhe V të këtij Aktgjykimi duke u bazuar në nenin 46 par. 4 të LKA-së. Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, përkatësisht që të hedh si të palejuar kërkesëpadinë e paditësit me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se paditësi është pajisur me lejet mjedisore për njësitë "HC Brodi 2" nr. 810265037, "HC Brodi 3" nr. 810165053 dhe "Restelica 1 & 2" nr. 810265045 pas miratimit në heshtje të kërkesës për leje mjedisore nr. prot. 4115/16 të datës 19.09.2016, kërkesës nr. prot. 5629/20 të datës 04.12.2020 dhe kërkesës nr. prot. 3635/21 të datës 09.09.2021 dhe që të detyrohet i padituri Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës që në afat prej tridhjetë (30) ditëve në formë të shkruar të lëshoj lejet e miratuara në heshtje sipas kërkesës për leje mjedisore nr. prot. 4115/16 të datës 19.09.2016, kërkesës nr. prot. 5629/20 të datës 04.12.2020 dhe kërkesës nr. prot. 3635/21 të datës 09.09.2021 për njësitë "HC Brodi 2" nr. 810265037, "HC Brodi 3" nr. 810165053 dhe "Restelica 1 & 2" nr. 810265045, pasi që gjykata vlerëson se objekt shqyrtimi në këtë konflikt administrativ ka qenë ligjshmëria e Vendimit KSHA nr. 43/22 të datës 10.04.2022, nr. prot. 4115-3/22 datë 11.10.2022 dhe Vendimit nr. rend. 7/2022 dhe nr. prot. 22-INS-SK-23-PV-25 të datës 29.07.2022, ndërsa çështja e konstatimit të miratimit në heshtje dhe detyrimit për nxjerrjen e vendimeve në formë të shkruar bie jashtë objektit të shqyrtimit të ligjshmërisë së vendimeve kontestuese. Duke qenë se gjykata aprovoi kërkesëpadinë e paditësit për anulimin e vendimeve kontestuese, gjykata la në fuqi shtyrjen e ekzekutimit të Vendimit KSHA nr. 43/22 të datës 10.04.2022 i protokolluar me numër nr. prot. 4115-3/22 datë 11.10.2022, sipas Aktvendimit të kësaj gjykate KA.nr. 1418/22 i datës 16.12.2022.

Dhoma e Shkallës së Dytë duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të Dhoma e Shkallës së Parë dhe konstaton se drejtë ka zbatuar dispozitat ligjore të LKA, dhe LPA-së, kur ka vendosur për të aprovoj pjesërisht padinë e paditësit në kuptim të nenit 13 par. 1 nën par 1.2 lidhur me par.5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Njëjtë si Dhoma e Shkallës së Parë edhe kolegji, vlerëson se veprimet e të paditurit janë në kundërshtim me interesin juridik dhe nuk arrijnë qëllimin e veprimit të organit të administratës, në këtë rast inspektimi nuk arrin qëllimin për të cilin është paraparë një mekanizëm i tillë kontrolli, pasi që i padituri në rast se do të kishte vlerësuar se paditësi nuk i plotëson kushtet për t'u pajisur me leje mjedisore, ka pasur mundësi që të refuzoj kërkesën e paditësit për t'u pajisur me leje, dhe jo pas mos veprimit brenda afateve ligjore sipas kërkesës së paditësit dhe pas mos veprimit edhe sipas kërkesës së përsëritur të paditësit për nxjerrjen e aktit të miratuar në heshtje, të ndërmarr veprime të inspektimit nëse paditësi është pajisur me leje mjedisore kur i njëjti organ administrativ ka tejkalluar afatet për vendosje sipas kërkesës së paditësit për pajisje me leje mjedisore. Andaj Kolegji, ka vlerësuar se Dhoma e Shkallës së Parë ka vendosur si në dispozitiv pika I, II dhe V duke u bazuar në nenin 46 par. 4 të LKA-së, pasi që i padituri në shkelje të parimit të pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme dhe në shkelje të parimit të proporcionalitetit ka realizuar inspektim nëse paditësi ka qenë i pajisur me leje mjedisore përderisa i njëjti organ administrativ ka rënë në vonesë të vendosjes sipas kërkesave të paditësit për pajisje me leje mjedisore.

Pretendimet ankimore të paditësit se nuk është vërtetuar gjendja faktike sa i përket padisë dhe kërkesëpadisë, kjo për faktin se paditësi për shkak të ekonomizimit të shqyrtimit gjyqësor ka kërkuar që me këtë padi të vërtetohet edhe për miratimin në heshtje të kërkesave për leje mjedisore, për shkak se paditësi ka dëshmuar se ka dorëzuar kërkesat për lëshimin e vërtetimit mbi "Miratimin në Heshtje" për dhënien e lejeve mjedisore për tri njësi, po ashtu paditësi i është drejtuar sërish të paditurës me kërkesën për lëshimin e vërtetimit mbi miratimin në heshtje. kolegji i refuzon si të pa bazuara, jo të qëndrueshme dhe pa ndikim për vendosjen ndryshe të çështjes, sepse kolegji vlerëson se në Dhomat e Shkallës së Parë vlerësohet ligjshmëria e vendimit të kontestuar të paditurës, ndërsa çështja

e konstatimit të miratimit në heshtje dhe detyrimit për nxjerrjen e vendimeve në formë të shkruar bie jashtë objektivit të shqyrtimit të ligjshmërisë së vendimeve kontestuese.

Sa i përket pretendimeve ankimore të paditurës, se Gjykata Komerciale Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjatë procedurës së zhvilluar në këtë çështje administrative ka bërë shkelje qenësore të dispozitave të nenit 182 par.1 pika n) të LPK-së këto pretendime ankimore nuk qëndrojnë, ngase aktgjykimi i Dhomës së Shkallës së Parë nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës administrative, dhe kontestimore e as me shkelje të tjera të cilat do të ndikonin në drejtëshmërin dhe ligjshmërinë e aktgjykimit të goditur. Meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka shqyrtuar padinë, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së, dhe LPA-së. E paditura në rastin konkret nuk ka paraqitur asnjë provë konkrete me të cilën do të mund të konstatonte një gjendje tjetër faktike nga gjendja e konstatuar nga Dhoma e Shkallës së Parë, pasi Dhoma e Shkallës së Parë në bazë të provave të administruara në seancën kryesore, si dhe shkresave të tjera ka nxjerrë prova të mjaftueshme dhe në mënyrë të plotë dhe të drejtë e ka vërtetuar gjendja faktike, me rastin e aprovimit të pjesërisht të kërkesë padisë së paditësit, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit, bazuar në faktet e paraqitura si në arsyetim të aktgjykimit të mbështetura në dispozitat ligjore.

Lidhur me pretendimet ankimore të paditurës se gjykata gabimisht ka vlerësuar se vendimi i të paditurit përmban të meta kjo nuk qëndron, pasi që vendimi si në hyrje në arsyetimin e tij është nxjerrë konform strukturës dhe elementeve të detyrueshme të aktit administrativ të përcaktuara në nenin 47, 48 dhe 49 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Kolegji këto pretendime nuk i aprovoj pasi që vlerësoi se vendimi i të paditurit që të ndërpres punën e paditësit përderisa i njëjti paraprakisht ishte pajisur me të gjitha lejet / pëlqimet e kërkuara për ndërtimin e hidrocentraleve, dhe pas përfundimit të ndërtimit i njëjti kishte aplikuar për pajisje me leje mjedisore, ndërsa i padituri nuk kishte vepruar brenda afateve ligjore të përcaktuara, paditësit kishte konsideruar se është pajisur me leje mjedisore përmes aprovimit në heshtje, në këtë rast vendimi i të paditurës për ndalimin e procesit të punës nga i padituri është në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit, respektivisht në kundërshtim me dy kushtet e përcaktuara në par 2, nën par. 2.1 dhe 2.2 të nenin 5 të Ligjit për Procedurën e përgjithshme Administrative. Ndërsa e paditura edhe pse

ka pasur kërkesa të përsëritura nga paditësi për tu pajisur me leje mjedisore, e njëjta nuk ka vendosur për kërkesat brenda afateve ligjore.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore të paditësit dhe të paditurës së Dhoma e Shkallës së Parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale, dhe se për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nuk ka mundur të bëhet zbatimi i drejtë i të drejtës materiale. Këto pretendime ankimore kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se te njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga Dhoma e Shkallës së Parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i Dhomës së Shkallës së Parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, andaj, ankesa e paditësit dhe të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se Dhoma e Shkallës së Parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit të pjesërisht të kërkesëpadsisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesat e palëve ndërgjyqëse u refuzuan si e pa bazuara, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë gjendje të fakteve Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson, se Dhoma e Shkallës së Parë, drejtë kanë vërtetuar gjendjen faktike të çështjes në shqyrtim dhe drejtë ka zbatuar dispozitat e Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, dhe të LKA-së, dhe nuk është cenuar e drejta dhe ligji në dëm të paditësit dhe të paditurës. Pasi që me thëniet në ankesa aktgjykimi nuk vihet në dyshim, i njëjti vërtetohet si drejtë i bazuar në prova dhe ligj.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS –Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.636/24, me datë 11.07.2024

Kryetare e kolegjit,
Franciska Zhitija Ymeri